



## Informata për Rregullativën e përgjithshme të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR)

### Hyrje

Këto informata kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve të BE-së lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga ana e Komercijalna Banka AD Skopje, në përputhje me **Rregullativën e përgjithshme të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR)**.

### 1. Identiteti i kontrolluesit dhe kontakti për të dhënat personale

**Kontrolluesi:** Komercijalna Banka AD Skopje

Adresa: rr. Orce Nikolov nr. 3, 1000 Shkup (R. e Maqedonisë)

Tel.: +3892 3296800

**Kontakti për të dhënat personale:** Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale

E-mail: [dataprotection\\_info@kb.com.mk](mailto:dataprotection_info@kb.com.mk)

### 2. Të dhënat personale që i përpunon Banka dhe burimet prej nga i merr këto të dhëna

Banka i përpunon të dhënat personale që i merr nga klientët prej fillimit dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies afariste. Përveç kësaj, sipas nevojave për sigurimin e shërbimeve, Banka përpunon edhe të dhënat personale që mund të sigurohen dhe lejohen për përpunim nga burimet që janë të hapura për publikun (psh. Regjistri i kredive, Agjencia e kadastrit të pasurisë së patundshme, Drejtoria e të hyrave publike, KIBS AD Skopje, Përmbaruesit, Noterët, Zyrat e kreditit, Policia financiare, Prokuroria publike, si dhe institucione të tjera të rregulluara me Ligjin për bankat ose të transferuara nga palët e treta të autorizuara me ligj).

Të dhënat personale përfshijnë të dhëna (emri, mbiemri, adresa, të dhëna për kontakt, data dhe vendi i lindjes dhe nënshtetësia), të dhëna që kanë të bëjnë me identifikimin (psh. kopje e dokumentit të identifikimit personal) dhe të dhëna për autentifikim (p.sh. shembull i nënshkrimit). Gjithashtu mund të përfshijë edhe të dhëna të tjera (p.sh. instruksionet e pagesave), të dhëna nga përmbushja e detyrimeve kontraktuale, informacione në lidhje me gjendjen financiare (p.sh. të dhëna në lidhje me aftësinë kreditore, rangime të kredive të burimit të mjeteve), të dhëna nga regjistrat, të dhëna për përdorimin e mediave digjitale (p.sh. kohën e qasjes në faqen e internetit të Bankës, faqet e vizituara të internetit dhe të ngjashme) si dhe të dhëna tjera të cilat mund të krahasohen më këto kategori.

### **3. Objektivat dhe baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale në Bankë**

Banka bën përpunimin e të dhënave personale për përmbytjen e detyrimeve kontraktuale, për qëllime të interesave legjitime, në bazë të detyrimeve ligjore ose interesit publik, si dhe në bazë të pëlqimit të dhënë nga klienti.

#### **3.1. Përmbytja e detyrimeve kontraktuale (neni 6/1/b, GDPR)**

Përpunimi i të dhënave personale bëhet me qëllim që të mundësohet përdorimi i produkteve dhe shërbimeve bankare, përkatësisht për përmbytjen e kontratave të lidhura me klientët. Përpunimi i të dhënave personale bëhet kryesisht në lidhje me një produkt të caktuar (p.sh. llogaritë, kreditet, kartat e debitit dhe kreditit, sigurimi dhe depozitat e kursimeve), ndërsa objektivat mund të përfshijnë edhe analizën e qëllimeve të investimit, sigurimin e këshillave, shërbime lidhur me menaxhimin e mjeteve dhe realizimin e transaksioneve duke përfshirë edhe ndarjen e të dhënave me kompani të tjera ose vende të treta në përputhje me udhëzimet për pagesë.

#### **3.2. Interesat legjitime (neni 6/1/f, GDPR)**

Nëse është e nevojshme, Banka i përpunon të dhënat më shumë se afati minimal për kryerjen e shërbimeve që ofron për klientët, si dhe për mbrojtjen e interesave të klientëve. Këtu hyjnë këto raste:

- reklamimi i produkteve të bankës, në bazë të pajtueshmërisë për përdorimin e të dhënave personale;
- kërkesat ligjore dhe rregullative;
- mbrojtja e sigurisë së sistemeve të TIK (Teknologjisë Informative dhe Kompjuterike) të Bankës;
- parandalimi dhe hetimi i veprave kriminale;
- video mbikqyrja për mbrojtjen e pronës së Bankës, punonjësve dhe klientëve (duke përfshirë edhe të drejtën për sigurimin e dëshmimeve në rast të vjedhjes ose mashtrimit, vërtetimin e pagesave ose tërheqjes së mjeteve (p.sh. në bankomat) etj.;
- kujdesi dhe vendosja e masave të sigurisë (p.sh. kontrolli i qasjes);
- ndarja e të dhënave personale me kompanitë në përputhje me detyrimet kontraktuale ose ligjore.

### **3.3 Detyrimet ligjore (neni 6/1/c, GDPR) ose interesi publik (neni 6/1/e, GDPR)**

Banka i përpunon të dhënat personale në përputhje me detyrimet ligjore, (Ligji për banka, Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rregulloret e taksave, etj.) si dhe në bazë të kërkesave rregullatore të vendosura nga institucionet si Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë ose institucione të tjera të rregulluara me ligj. Të dhënat përpunohen për nevoja të tilla si kontrollimi i kredive, verifikimi i identitetit, identifikimi për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave, përmbushja e detyrimeve për pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale, njoftime në përputhje me Ligjin për tatimin mbi të ardhurat personale dhe aktet përkatëse nënligjore, etj.

### **3.4. Pëlqimi i klientit (neni 6/1/a, GDPR)**

Banka përpunon të dhënat personale në bazë të pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të caktuara (p.sh. për qëllime marketingu). Pëlqimi mund të tërhiqet në çdo kohë, duke përfshirë edhe pëlqimin e dhënë para zbatimit të GDPR, respektivisht para 25 maj 2018. Revokimi i pëlqimit nuk do të ndikojë në të dhënat e përpunuara para tërheqjes së pëlqimit.

## **4. Përdoruesit e të dhënave personale**

Qasje në të dhënat personale kanë punonjësit në njësitë organizative në Bankë të cilëve u nevojiten të dhënat për qëllime të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ligjore ose që kanë interes legjitim.

Banka mund të japë informata për klientët vetëm nëse është detyrim ligjor ose nëse klienti ka dhënë pëlqim për këtë veprim. Si rrjedhojë, përdorues të të dhënave personale mund të jenë:

- organet shtetërore, subjektet që kryejnë autorizime publike dhe institucionet (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, organet tatimore, noterët, përmbaruesit, personat e kualifikuar, autoritetet gjyqësore, etj.) nëse ekziston detyrim ligjor dhe
- bankat dhe institucionet e tjera që ofrojnë shërbime financiare ose institucione të ngjashme ku Banka ju dërgon të dhënat personale (bankat korrespondente, bankat depozituese, bursat, agjencitë e kreditit etj.).

Banka gjithashtu u jep të dhënat personale dhënësve të shërbimeve dhe agjentët që lidhen me këto fusha: shërbimet e kredive, taksat dhe kontabiliteti, shërbimet e teknologjisë informative, logjistikën, shërbimet botuese, telekomunikacionet, pagesa e borxheve, shërbimet e konsulencës dhe këshilluese, shitjet dhe marketingu. Të dhënat personale të dhënësve të shërbimeve mund të jepen vetëm në bazë të kontratës së lidhur me dhënësin e shërbimit dhe kontrollin paraprak që ato i plotësojnë kushtet për përpunimin ligjor të të dhënave personale.

Lidhur me dhënien e të dhënave personale përdoruesve, Banka kujdeset për konfidencialitetin dhe obligimin për ruajtjen e sekretit bankar.

## **5. Afatet për ruajtjen e të dhënave personale në Bankë**

Banka i përpunon dhe i ruan të dhënat personale aq sa është e nevojshme për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale dhe ligjore.

Banka i nënshtrohet detyrimeve të ndryshme sa i përket ruajtjes dhe dokumentimit të të dhënave në përputhje me Ligjin për banka, Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Ligjin për punët arkivore, Ligjin mbi procedurën tatimore, etj. Afatet kohore të përcaktuara në këto ligje dhe rregullore për ruajtjen e evidencave dhe/ose dokumentacionit mund të jenë prej pesë deri në dhjetë vjet pas përfundimit të marrëdhënies afariste me klientin. Nëse rregullativa ligjore kërkon ruajtje më të gjatë të të dhënave, atëherë Banka i ruan të njëjtat edhe më shumë se 10 vjet, në përputhje me kërkesat ligjore.

## **6. Transferimi i të dhënave personale në vendet e treta**

Të dhënat personale transferohen në vendet e treta (vendet e BE-së, si dhe vendet jashtë BE-së) vetëm nëse kërkohet me qëllim të realizimit të urdhëresave (urdhërpagesave, urdhëresave lidhur me letrat me vlerë dhe transferimit të shpejtë të parave), nëse është paraparë me ligj/rregullore ose nëse është dhënë pëlqim për këtë veprim.

## **7. Të drejtat e subjekteve për mbrojtjen e të dhënave personale**

Sipas GDPR, të drejtat e mbrojtjes së të dhënave personale janë: e drejta për qasje në të dhënat personale (neni 15, GDPR), e drejta për korrigjim (neni 16, GDPR), e drejta për të fshirë (neni 17, GDPR), e drejta për kufizimin e përpunimit (neni 18, GDPR), e drejta për kundërshtim (neni 21, GDPR) dhe e drejta për transportueshmëri (neni 20, GDPR). Lidhur me të drejtën e qasjes dhe të drejtën për të fshirë, zbatohen disa kufizime në përputhje me Ligjin për bankat, Ligjin për punët arkivore, Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligjin për procedurën tatimore, Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

## **8. Obligimi për të dorëzuar të dhënat personale në Bankë**

Gjatë lidhjes së marrëdhënies afariste, klienti është i obliguar të paraqesë në bankë të dhënat personale të cilat janë të nevojshme për të filluar dhe për të vazhduar marrëdhënien afariste, respektivisht për përmbushjen e detyrimeve të nevojshme kontraktuale. Sipas Ligjit për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Banka ka një obligim të veçantë për të identifikuar klientin para se të lidhë marrëdhënien afariste (ti sigurojë dhe evidentojë të dhënat siç janë emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, shtetësia, adresa dhe të dhëna tjera për identifikim, si dhe kopje të dokumenteve për identifikim

personal), si dhe të përditësojë në periudha të caktuara kohore dokumentet për identifikim, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies afariste.

## **9. Përdorimi i vendimeve automatike**

Banka nuk përdor vendimet plotësisht të automatizuara, në përputhje me nenin 22 të GDPR, për themelimin dhe vazhdimin e marrëdhënies afariste. Me kërkesë të klientit, Banka do ta informojë më hollësisht për të njëjtën.

## **10. Profilizimi**

Banka përpunon të dhënat personale në bazë pjesërisht të automatizuar, me qëllim të përdorimit të të dhënave personale për vlerësimin e disa aspekteve personale dhe në veçanti për analizimin ose parashikimin e aspekteve që kanë të bëjnë, për shembull:

- me parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit ose pengimin e veprimtarive tjera kriminale që çojnë në rrezikun e dëmtimit të pronës. Në këtë kuptim, bëhen analiza të të dhënave (p.sh. të dhënat mbi transaksionet e pagesave).
- gjatë vlerësimit të aftësisë kreditore, me qëllim që të llogaritet probabiliteti se sa klienti do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij të pagesave në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes. Gjatë llogaritjes, mund të merren parasysh pikat e mëposhtme: të hyrat, të dalat, obligimet ekzistuese, profesioni, punëdhënësi, përvoja e punës, përvoja nga marrëdhëniet e mëparshme afariste, shlyerja e kredive të mëparshme sipas kontratës së paraparë dhe informatat e marra nga agjencitë e kreditit.
- gjatë përdorimit të Internetit, shërbimit mBanka ose kartave, Banka bën ndjekjen e vazhdueshme të transaksioneve të pagesave, për shkaqe sigurie dhe me qëllim të parandalimit të abuzimeve në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse.
- në bazë të pëlqimit të dhënë, për sigurimin e informatave dhe këshillave të personalizuara në lidhje me produktet dhe shërbimet e Bankës, ku edhe përdoren analiza të brendshme të të dhënave.

## **11. Informata mbi të drejtën e kundërshtimit sipas nenit 21 të Rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR)**

Klienti ka të drejtë të kundërshtojë, në çdo kohë, në lidhje me përpunimin e të dhënave të tij personale, që bazohet në nenin 6/1/v, GDPR (përpunimi i të dhënave në interes publik) dhe neni 6/1/gj, GDPR (përpunimi i të dhënave në bazë të interesave legjitime). Kjo vlen gjithashtu edhe për çdo profilim të bazuar në këtë dispozitë në përputhje me nenin 4 pika 4, GDPR të cilën Banka e përdor për qëllime të klasifikimit të kredisë ose për qëllime reklamuese.

Në rast të një kundërshtimi, Banka nuk do të vazhdojë të përpunojë të dhënat personale përveç nëse ekziston një interes ligjor ose legjitim për përpunimin e të dhënave personale që tejkalojnë të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale. Banka përdor disa të dhëna personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë. Klienti ka të drejtë në çdo kohë të kundërshtojë lidhur me përpunimin e të dhënave personale që kanë të bëjnë me këto qëllime marketingu. Kjo vlen edhe për profilizimin, në rastin kur ka të bëjë me marketingun e tillë të drejtpërdrejtë. Në rast të kundërshtimit për përpunimin për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë, Banka nuk do të përpunojë më tej të dhënat personale për këtë qëllim.

Kundërshtimi nuk i nënshtrohet ndonjë lloj kërkesë formale dhe duhet të adresohet tek:

**Komercijalna Banka AD Skopje**

**Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale**

**rr. Orce Nikolov nr. 3**

**1000 Shkup, R. e Maqedonisë**

**e-mail: [dataprotection\\_info@kb.com.mk](mailto:dataprotection_info@kb.com.mk)**